

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE "PROMOLLOTO" sh.p.k.**

**KAPITULLI 1**

**Dispozita te Pergjithshme**

- **Elis Sulaj**, atësia Agim, amësia Flora, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues me adresë Rr. Xhoxhi Martini; Tiranë, lindur më 31/08/1986, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. personal I608310640.

Ortaku me lart është madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i cili mbështetur në ligjin Nr.9901, dt.14/04/2008, "Për Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, vendosi sot me datë **03/09/2024**, si më poshtë vijon:

**Emertimi, Selia dhe afati i Shoqërisë**

**Neni 1**

Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, për të zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e të cilit rregullohet nga akt themelimi, statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

**Neni 2**

Shoqëria do të emërtohet "**PROMOLLOTO**" sh.p.k.

**Neni 3**

Shoqëria do të ketë Selinë e saj në Tiranë, Rruga "Xhoxhi Martini", Nd. Nr. 17, H.1.

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

**Neni 4**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Afati mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 5**

**Aktiviteti i shoqërisë**

Shoqëria "**PROMOLLOTO**" sh.p.k. do të ketë si objekt:

- Ofrimin e shërbimit të Marketingut në përgjithësi, shërbime reklamimi dhe promovimi të produkteve të ndryshme;
- Hartimin, projektimin dhe zbatimin për Lojra Fati Promocionale për llogari të subjekteve vendase apo të huaja;
- Konsulencë në krijimin dhe organizimin e Lojrave të Fatit për të gjitha kategoritë e lejuara për llogari të subjekteve të licencuara;
- Konceptimin dhe zbatimin e konkurseve që zhvillohen në baze të njohurive të pjesëmarrësve apo në baze të aftësive të pjesëmarrësve ku fituesi merr një çmim të caktuar;
- Hartimi, projektimi, zbatimi i fushatave promovuese, eventeve dhe evenimenteve të cdo lloji;
- Hartimi, projektimi dhe zbatimi i fushatave të publicitetit në formë të ndryshme të komunikimit publik, realizim i spektakleve, filmave, shfaqjeve me karakter argetues;



- Blerja dhe shitja e hapësirave mediatiqe në rolin e agjentit, negocimi, kontraktimi kryerja e shërbimeve në fushën e hapësirave mediatiqe. Shërbime ndihmëse, konsulence në fushën e mediave të cdo lloji;
- Blerja dhe shitja e produkteve reklamuese apo materialeve të ndryshme dixhitale dhe të printuara;
- Krijime, përpunime, realizime grafike, botime, shtypje librash, revistash, fletpalosje, reklama, bileta eventesh etj;
- Dizënjim, zhvillim, zbatim, shitje apo dhënie me qera sistemesh për administrimin elektronik të biletave. Mirembajtje dhe ofrimi i asistencës teknike për këto lloje sistemesh. Shitje biletash për aktivitete kulturore, sportive, turistike, transport urban e interurban etj, nga platforma të ndryshme;
- Të kryejë cdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me sistemet e biletarise së shtypur apo elektronike si dhe cdo aktivitet apo veprimtari tjetër të cilat mund të konsiderohen të dobishme, plotësuese ose të nevojshme për realizimin e qëllimeve të shoqërisë, me kusht që këto veprime apo aktivitete të mos sjellin ndryshim themelor të objektit të veprimtarisë së shoqërisë;
- Konceptimin, krijimin, zhvillimin dhe zbatimin e aplikacioneve softwerike, faqeve të internetit, sistemet e plota të IT dhe platformat IT. Ushtrimi i aktiviteteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve. Operimi, menaxhimi, testimi, suport i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software;
- Blerja dhe shitja e cdo lloji materiali me shumicë dhe pakicë dhe cdo lloji shërbimi që lejohet nga legjislati në fuqi. Cdo aktivitet tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit të shoqërisë.

## **Neni 6 Kapitali**

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave e përfitojnë ortakët e saj.

Ortaku themelues përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së saj të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund të rritet nga fitimi në natyrë, ose kredi në leke ose valute që merret në Bankat e Shtetit Shqiptar.

Kapitali themeltar për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë është në 100 Leke, që i takon ortakut themelues si më poshtë:

**1. Ortaku Elis Sulaj: Zoterues e 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 100 Leke që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

## **NENI 7 Organi Vendimmarres**

Shoqëria është e organizuar në organet e mëposhteme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqërisë
- 2- Administratori

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin përkatës. Administrastoret e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakeve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



**NENI 8**  
**Administrimi**

1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë për një afat 5 vjecar nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie pranë QKB-se dhe do të veprojë me tagra të pakufizuara.

- **Elis Sulaj**, atësia Agim, amësia Flora, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues me adresë Rr. Xhoxhi Martini; Tiranë, lindur më 31/08/1986, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. personal I60831064O, i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e perfaqësimit të shoqërisë me të tretet në gjithë veprimtarinë e shoqërisë në mënyrë të pavarur.

**Specimenti i Firmes (Firma):**

  
\_\_\_\_\_;

**NENI 9**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**NENI 10**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**NENI 11**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.



Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **NENI 12**

#### **Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar. Ky akt themelimi eshte i pergatitur ne 2 (dy) kopje te barazvlefshme ne gjuhen.

**ORTAKU I SHOQERISE  
"PROMOLLOTO" sh.p.k  
ELIS SULAJ**

